



Republika e Shqipërisë
Ministria e Shëndetësisë

UDHËZUES
PËR PLOTËSIMIN
E
KARTELËS SË RE STOMATOLOGJIKE

Tiranë

2011

Autorët

ENE NUREDINI	Ministria e Shëndetësisë, specialist i Shërbimit Stomatologjik
ORIANA TAMBURI	ASHR, Shërbimi Stomatologjik Publik
MARVIN MERSINI	ASHR, Shërbimi Stomatologjik Publik
ELVIS XHAJA	ASHR, Shërbimi Stomatologjik Publik
ZHELMIRA THOMAJ	ASHR, Shërbimi Stomatologjik Publik
DORJAN HYSI	Kryetari i Shoqatës Dentare Shqiptare
ARJANA MALLTEZI	ASHR, Shërbimi Stomatologjik Publik
PRANVERA DANGO	ASHR, Shërbimi Stomatologjik Publik
ROZARKA BUDINA	Drejtoreshë e Klinikës Stomatologjike Universitare
RUZHDI QAFMOLLA	Shefe e Departamentit të Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, UT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Përshkrimi i kartelës së re stomatologjike.....	3
Udhëzime për plotësimin e kartelës së re stomatologjike.....	4
Përfundime.....	20

HYRJE

Përmirësimet sasiore dhe cilësore në Shërbimin Stomatologjik Publik përgjatë pesë viteve të fundit, aplikimi i vazhdueshëm i procedurave profilaktike për parandalimin e sëmundjeve të gojës e të dhëmbëve, futja e disa koncepteve bashkëkohore në organizimin e punës të mjekëve stomatologë të këtij shërbimi, e bënë të domosdoshme krijimin e një karteje të re stomatologjike, e cila do të plotësonte këto kushte:

- Të ishte praktike në përdorim
- Të pasqyronte me saktësi, qartësi dhe sipas standardeve të kërkuara prej OBSH-së gjendjen e gojës së fëmijëve
- Të pasqyronte me saktësi e qartësi punën e kryer nga mjeket stomatologe të shkollave me fëmijët.

PËRSHKRIMI I KARTELËS SË RE STOMATOLOGJIKE

Kartela e re stomatologjike përbëhet nga katër faqe, të cilat ofrojnë mundësinë për të përshkruar në mënyrë të detajuar nivelin e shëndetit oral të fëmijës, kujdesin dhe zakonet e tij në lidhje me këtë shëndet, trajtimet që ka përfituar ai prej Shërbimit Stomatologjik Publik, vërejtje të ndryshme gjatë punës me të dhe shenjat konvencionale që do të përdoren gjatë plotësimit të saj.

Faqja e parë, e dytë dhe pjesërisht faqja e katërt e kartelës përmbajnë hapësirat e nevojshme për të pasqyruar të dhënat e mbledhura gjatë depistimit të fëmijëve dhe trajtimet profilaktike të tyre.

Faqja e tretë dhe pjesërisht faqja e katërt përmbajnë hapësirat për të pasqyruar mjekimin e patologjive të gojës e të dhëmbëve.

Më konkretisht, *faqja e parë* përmban hapësirat e nevojshme për të pasqyruar:

1. Të dhënat e përgjithshme,
2. Miratimin e prindit për trajtimin e fëmijës në shkollë

3. Gjendjen e përgjithshme shëndetësore
4. Fluorizimin
5. Nivelin e higjienës së gojës
6. Praninë ose mungesën e patologjive të indeve të buta
7. Praninë ose mungesën e anomalive të nofullave e të dhëmbëve
8. Praninë ose mungesën e defekteve të indeve të forta të dhëmbëve
9. Të dhënat mbi silanimin e fëmijëve

Faqja e dytë është parashikuar për të pasqyruar gjendjen e dhëmbëve të fëmijëve.

Faqja e tretë është parashikuar për të pasqyruar mjekimet e dhëmbëve të fëmijëve

Faqja e katërt është parashikuar për të pasqyruar dhe përshkruar probleme e patologji të vëna re gjatë depistimit apo procedura mjekimi që nuk mund të përshkruhen në faqet përkatëse. Në këtë faqe jepen edhe shenjat konvencionale që do të përdoren për të përshkruar gjendjen e dhëmbëve të fëmijëve.

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E KARTELËS SË RE STOMATOLOGJIKE

1. Faqja e parë

Kjo faqe (me përjashtim të zërit "Silanime") do të plotësohet gjatë depistimit të fëmijës.

Për arsye praktike, do të dallojmë dy momente në plotësimin e saj:

a. Kartela dentare plotësohet në qendrën shëndetësore kur fëmija vjen për mjekim.

Në këtë rast faqja e parë (dhe të gjitha hapësirat për ekzaminimin e fëmijës) do të plotësohen në të njëjtën seancë.

b. Kartela dentare plotësohet në klinikën dentare të shkollës.

Në këtë rast, i takon zyrës së SHSP-së që të udhëzojë mjekët/mjeket stomatolog/e nëse depistimin e plotë do ta bëjnë me një seancë, apo do të kërkojnë depistime të veçanta për patologji të caktuara.

1.1. Të dhëna të përgjithshme

Kjo hapësirë është parashikuar për të pasqyruar të dhënat e përgjithshme të një fëmije. Përveç të dhënave kryesore: emri, mbiemri, klasa dhe shkolla, kartela e re është pasuruar edhe me informacionin mbi gjininë e fëmijës, datën e lindjes dhe vendlindjen e tij.

Një shembull i plotësimit të këtij kuadrati është dhënë në figurën 1.

1.2 Miratimi i prindit për trajtimin e fëmijës nga mjeku stomatolog i shkollës

Miratimi me shkrim i pacientit për disa apo të gjitha trajtimet që do të përftojë prej shërbimeve shëndetësore është një nga standardet e reja të nevojshme për akreditimin e shërbimit stomatologjik edhe në vendin tonë (Ministria e Shëndetësisë, “Standardet e Akreditimit të Shërbimit Stomatologjik”, 2010).

Aktualisht, të gjithë fëmijët që drejtohen për trajtim stomatologjik pranë SHSP-ve janë ose kërkohet të jenë të shoqëruar nga prindi ose një tjetër person i rritur i familjes. Në momentin që e sjell fëmijën për trajtim, prindit do t’i kërkohet që në këtë hapësirë të shkruajë me shkrim dore: emrin, mbiemrin, firmën dhe numrin e vet të telefonit, përmes të cilit ne mund të kontaktojmë me të në rastet e nevojshme.

Një shembull i plotësimit të këtij kuadrati është dhënë në figurën 2.

Hapësira përkatëse në kartelë

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	
Emri	
Mbiemri	
Datëlindja	
Vendlindja	
Gjinia	<input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> M
Shkolla	
Klasa	

Hapësira e plotësuar

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	
Emri	Oriana
Mbiemri	Tamburi
Datëlindja	11.11.2011
Vendlindja	Tirane
Gjinia	<input checked="" type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> M
Shkolla	Naim Frasheri
	Arben Broci
Klasa	1/A

Fig. 1: Shembull i plotësimit të kuadratisë “Të dhëna të përgjithshme”
Hapësira përkatëse në kartelë

MIRATIMI I PRINDIT PËR TRAJTIMIN E FËMIJËS NË SHKOLLË			
Pranoj që fëmija im të trajtohet nga mjeku stomatolog i shkollës			
Emri	Mbiemri	Firma	Numri i telefonit:

Hapësira e plotësuar

MIRATIMI I PRINDIT PËR TRAJTIMIN E FËMIJËS NË SHKOLLË			
Pranoj që fëmija im të trajtohet nga mjeku stomatolog i shkollës			
Emri	Mbiemri	Firma	Numri i telefonit:
Emri	Mbiemri	<u>EMbiem</u>	06X XX XXXXX

Fig. 2: Shembull i marrjes së miratimit me shkrim të prindit për trajtimin e fëmijës në shkollë.

1.3 Të dhëna mbi gjendjen e përgjithshme shëndetësore

Kjo hapësirë është krijuar në kartelë për të shënuar ndonjë sëmundje të fëmijës me ndikim në gjendjen e gojës e të dhëmbëve apo në trajtimin e tij.

Për plotësimin e kësaj hapësire pyetet prindi, ndërsa fëmijët më të rritur (p.sh. adoleshentët, mund të përgjigjen vetë).

Hapësira përkatëse

GJENDJA E PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE	
a. A vuan nga ndonjë sëmundje?	c. A është alergjik?
b. A merr ndonjë mjekim?	d. A është i vaksinuar?

Hapësira e plotësuar

GJENDJA E PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE	
a. A vuan nga ndonjë sëmundje? <i>Jo</i>	c. A është alergjik? <i>Po, ndaj penicilines</i>
b. A merr ndonjë mjekim? <i>Jo</i>	d. A është i vaksinuar? <i>Po, ndaj TV-se</i>

Fig.3. Shembull i plotësimit të të dhënave për “Gjendjen e përgjithshme shëndetësore”.

1.4 Fluorizimi

Qëllimi i kësaj hapësire është që të marrim informacion

a. mbi fluorizimin individual të fëmijës në shtëpi, të mbikëqyrur prej prindit dhe

b. të pasqyrojmë fluorizimin që i ofrohet atij prej Shërbimit Stomatologjik Publik

FLUORIZIMI					
A ka marrë/merr fluor fëmija					
a. pastë me fluor					
b. tableta fluori					
c. silante/mbushje me çlirim fluori					
d. tjetër					
			Fluorizimi Lokal		

Fig. 4. Hapësira e parashikuar për të dhënat mbi fluorizimin e fëmijës.

Për të plotësuar *tabelën mbi fluorizimin individual të fëmijës* mund të pyetet prindi (për moshat 6-10 vjeç) dhe/ose vetë fëmija (për moshat mbi 11 vjeç)

Shembuj të plotësimit të kësaj hapësire janë dhënë në figurat 4.1 dhe 4.2

Në rreshtin e parë të tabelës do të shënohet data kur fëmija pyetet për herë të parë.

Më tej do të vijohet sipas rastit:

Rasti I: Fëmija nuk i është nënshtruar asnjërës prej metodave të fluorizimit individual. Në këtë rast do të shënohet vetëm data kur pyetet për herë të parë dhe tabela do të lihet e paplotësuar derisa gjendja të ndryshojë.

Rasti II: Fëmija i është nënshtruar njërës apo disa prej mënyrave të fluorizimit individual, por situata mbetet e pandryshueshme gjatë viteve të tjera të shkollimit të tij.

Në këtë rast do të plotësohet vetëm kolona e parë e tabelës dhe kolonat e tjera do të lihen bosh.

Në rreshtin e parë vendoset data kur pyetet fëmija.

Pastaj vendosen shenjat (+, √, x) në kuadratin që tregon mënyrën përmes të cilës e ka marrë fëmija fluorin.

Në zërin “**Tjetër**” është parashikuar të përmbliidhen rastet kur fëmija:

a. Është fluorizuar përmes ujit të pijshëm (ka jetuar për disa vite në vende që e aplikojnë ende fluorizimin e ujit të pijshëm apo fluorizimin e ujit të shitur me shishe)

b. Ka përdorur kripë të fluorizuar

c. Ka përdorur qumësht të fluorizuar

d. I është nënshtruar ndonjëherë prej metodave të fluorizimit lokal në një kabinet dentar privat (llak fluori, xhel fluori, solucion fluori i aplikuar me tampon etj).

Shembulli i plotësimit të kartelës në këtë rast është dhënë në figurën 4. 2.

FLUORIZIMI				
A ka marrë/merr fluor fëmija	xx/xx/20xx			
a. pastë me fluor	+			
b. tableta fluori				
c. silante/mbushje me çlirim fluori				
d. tjetër				

Fig. 4.1 Rasti II.

Rasti III

Fëmija i është nënshtruar njëherë prej metodave të fluorizimit lokal dhe mjeku stomatolog e merr këtë informacion prej tij në datë xx / xx / 20xx, kur e ekzaminon për herë të parë.

Fëmijës i bëhen edhe disa depistime të tjera dhe në datë xy / xy / 20xy rezulton se i janë bërë mbushje me çlirim fluori. Shënimi i radhës do të bëhet pikërisht në këtë datë.

Pas disa depistimesh të tjera, në datë *xz / xz / 20xz* rezulton se fëmija është fluorizuar edhe me llak fluori nga një mjek stomatolog i ndryshëm prej atij të shkollës.

Shembull i plotësimit të tabelës në këtë rast është dhënë në figurën 4.2.

FLUORIZIMI				
A ka marrë/merr fluor fëmija	<i>xx / xx / 20xx</i>	<i>xy / xy / 20xy</i>	<i>xz / xz / 20xz</i>	
a. pastë me fluor	+	+	+	
b. tableta fluori				
c. silante/mbushje me çlirim fluori		+	+	
d. tjetër <small>është fluorizuar me llak fluori nga mjeku stomatolog privat</small>			+	

Fig. 4.2 Rasti III.

Kuadrati në krah të majtë, “**Fluorizimi lokal**”, do të plotësohet çdo herë që fëmija i nënshtrohet metodave të fluorizimit kolektiv që aplikon SHSP-ja. Kolona e parë do të plotësohet semestrin e parë dhe kolona e dytë në semestrin e dytë.

Figura 4.3 ofron një shembull të plotësimit të kuadratit.

Fluorizimi Lokal	
<i>xx / xx / 20xx Sol. NaF</i>	
<i>xy / xy / 20xy llak fluori</i>	

Fig. 4.3. Shembulli i mësipërm merr parasysh rastin kur mbi fëmijën aplikohet solucion NaF gjatë fluorizimit të parë dhe llak fluori pas një viti.

1.5. Shënimet mbi higjienën e gojës

Gjatë depistimit mjeku/mjekja stomatolog/e i kushton vëmendje nivelit të higjienës së gojës së fëmijës.

Për të plotësuar këtë hapësirë, mjeku stomatolog duhet ta pyesë fëmijën se sa herë në ditë i lan dhëmbët dhe do të vërejë praninë ose mungesën e gurrëzave e të cipave.

Njësoj si në rastin për fluorizimin, nuk do të bëhen shënime të reja në kartelë për sa kohë që situata mbetet e njëjtë me depistimin e parë.

Figurat 5.1, 5.2, 5.3 udhëzojnë për mënyrën e plotësimit të kësaj hapësire në disa prej rasteve që mund të vihen re në praktikë.

HIGJIENA E GOJËS	
(larja e dhëmbëve, prania e gurëzave dhe e cipave)	
<i>xx/xx/20xx Dhembet lachen dy here ne dite, nuk ka gureza e cipa</i>	
<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	

Fig. 5.1 Rasti kur fëmija i kushton vëmendje të plotë higjienës së gojës.

HIGJIENA E GOJËS	
(larja e dhëmbëve, prania e gurëzave dhe e cipave)	
<i>xx / xx / 20xx Dhembet lachen me raste, vihet re nje prani e moderuar gurezash e cipash. Rekomandohet pastrim i tyre te mjeku stomatolog</i>	
<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	

Fig. 5.2. Rasti kur fëmija i lan dhëmbët me raste dhe kjo pasqyrohet në gojë me praninë e gurrëzave e të cipave. Prania e gurrëzave dhe e cipave mund të cilësohet me mbiemrat e lehtë, e moderuar, e theksuar.

HIGJIENA E GOJËS (Iarja e dhëmbëve, prania e gurëzave dhe e cipave)	
<i>xx / xx / 20x1</i>	<i>Dhembet lahen rralle, vihet re nje prani e theksuar gurezash e cipash. Rekomandohet pastrim i tyre te mjeku stomatolog.</i>
<i>xx / xx / 20x5</i>	<i>Dhembet lahen dy here ne dite, nuk vihen re gureza ose cipa.</i>

Fig. 5.3. Rasti kur fëmija paraqitet me një higjienë shumë të keqe të gojës në vizitën e parë, por pas disa vitesh situata ndryshon dhe ai/ajo ndërgjegjësohet për kujdesin që duhet t'i kushtojë gojës e dhëmbëve.

1.6 Patologjitë e indeve të buta të gojës

Gjatë depistimit mund të vihet re prania e një apo disa patologjive të indeve të buta. Më të shpeshta janë gingivitet, por mund të vihen re edhe stomatite, kandidoza, etj.

Ky kuadrat do të plotësohet gjatë depistimit të parë dhe, në rast se indet e buta janë të shëndosha, do të shënohet “nuk ka”.

Në rast se vihet re ndonjë patologji, do të shënohet data e ekzaminimit dhe emërtimi (në kllapa mund të shtohet lloji i mjekimit që ka marrë apo po merr fëmija për këtë patologji).

Plotësimi i radhës do të bëhet në datën kur vihet re se patologjia është shëruar plotësisht. (Mund të shënohet është shëruar, kur mjeku e thërret përsëri fëmijën për kontroll pas disa ditësh, ose “nuk ka” në rast se mjeku vë re mungesën e patologjisë gjatë një depistimi të dytë pas gjashtë muajsh).

Një shembull i plotësimit jepet në figurën 6.

SËMUNDJET E INDEVE TË BUTA TË GOJËS (gingivite, paradontopati, stomatite, afte, kandidozë etj)	
<i>xx / xx / 20xx</i>	<i>Gingivit ne regjionin ballor, i shoqeruar me pranine e pllakes bakteriale.</i>

Fig. 6.

1.7 Anomalitë e nofullave e të dhëmbëve

Fëmijët që depistojmë mund të kenë anomali dhëmbësh, nofullash apo të dyja bashkë. Ne mund të vëmë re, gjithashtu, aparat ortodontik në gojën e tyre kur ata janë nën trajtim, ose ata mund të pohojnë se e kanë ndërprerë trajtimin ortodontik për arsye të ndryshme.

Të gjitha këto është planifikuar të përshkruhen në kuadratin përkatës për “Anomalitë e dhëmbëve e të nofullave” (figura 7).

Në rast se është e nevojshme të bëhen përshkrime më të detajuara të ecurisë së trajtimit ortodontik, arsyeve të ndërprerjes së trajtimit, etj, mund të përdoren edhe kuadratet për shënimet e ndryshme në faqen e fundit të kartelës.

Një shembull i plotësimit të kuadratis përkatës jepet në figurën 7.1

Disa prej nozologjive që pritet të shënohen në kartelë janë:

a. Anomalitë e dhëmbëve:

❖ të numrit

Mungesë e dhëmbëve (anodontia)

Mungesë e një apo disa dhëmbëve (hipodontia)

Mbinumër i dhëmbëve (hiperdontia) (mesiodens, paramolar)

❖ Të pozicionit

Ektopikë (lingualë, palatinalë, vestibularë)

Transpozicioni (këmbimi i vendit të dhëmbëve në harkun dentar)

Rrotacioni (rrotullimi i dhëmbëve në harkun dentar)

Dhëmbë protruzivë

Dhëmbë retruzivë

Dhëmbë në infraokluzion

Dhëmbë në supraokluzion

Meziofleksion

Distofleksion

❖ Të formës e madhësisë së dhëmbëve

Mikroodontia

Makroodontia

Dhëmbët e Huçinsonit

b . Anomalitë e nofullave

Makrogeni
Mikrogeni
Makrognati
Mikrognati
Prognati
Progeni
Retrognati
Retrogeni
Kafshim i ulët
Kafshim i lartë
Kafshim i kryqëzuar

Shembuj të plotësimit të kartelës në të tilla raste janë dhënë në figurat 7.1, 7.2

ANOMALI NOFULLASH DHE DHËMBËSH	
Dt. xx/xx/20x1	35 dhe 45 ektopike
Dt. xy/xy/20x2	vihet re se 35 dhe 45 janë hequr për arsye ortodontike

Fig. 7.1 Rasti i plotësimit të kartelës së një fëmije me anomali të dhëmbëve 35 dhe 45 (dhëmbë ektopikë). Në figurë tregohet edhe plotësimi i kartelës në një depistim të dytë, kur vihet re trajtimi i anomalisë me metodën kirurgjikale.

ANOMALI NOFULLASH DHE DHËMBËSH	
Dt. xx/xx/20x1	Kafshim i hapur
Dt. xx/xx/20x2	Është nën trajtim ortodontik. Në gojë vihet re praninë e një aparati ortodontik fiks
Dt. xy/xy/20x3	Trajtimi ortodontik ka përfunduar dhe anomalia është korrigjuar

Fig. 7.2 Rasti i plotësimit të kartelës, kur fëmija kërkon trajtim ortodontik të mjeku përkatës pasi është diagnostikuar anomalia e tij.

1.8 Defektet e indeve të forta të dhëmbëve

Defektet e dhëmbëve mund të jenë të lindura ose të fituara. Për to është parashikuar një kuadrat më vete në kartelë, pasi disa prej tyre mund të trajtohen ose të ndiqen prej vetë mjekut stomatolog të shkollës.

Nozologjitë që pritet të shënohen në kartelë janë:

- Fluoroza
- Amelogenesis Imperfecta (Hipoplazia e smaltit, Hipokalçifikimi i smaltit , Hipomaturimi i smaltit, forma e kombinuar).
- Dentinogenesis Imperfecta
- Erozioni
- Abrazioni
- Ndryshimet e ngjyrës së dhëmbëve (nga tetraciklina, në terren të porfirisë eritropoietike, hiperbilirubinemisë)

Në rast se në dhëmbët e fëmijëve nuk vihen re defekte, në kartelë do të shënohet “Nuk ka”.

Në rast se vihen re, do të shënohet emërtimi i defektit përkatës.

Figura 8 ofron një shembull të plotësimit të kuadratit përkatës në kartelën stomatologjike.

DEFEKTE TË INDEVE TË FORTA TË DHËMBËVE
<i>Dt. xx/xx/20xx Amelogenesis imperfecta, tipi I (hipoplazi e smaltit)</i>

Fig. 8 Rasti i plotësimit të kartelës së një fëmije me *amelogenesis imperfecta* të tipit të parë.

1.9 Silanimi

Silanimi është një procedurë profilaktike që nënkupton mbulimin e fisurave të sipërfaqes okluzale të dhëmbëve me një material fotopolimerizues.

Silanimi mund të kryhet nga mjeku stomatolog i shkollës (siç është rasti i SHSP-së së rrethit të Tiranës) ose nga një mjek stomatolog privat (raste shumë të rralla deri më tani.)

Figurat 9 ofron mënyrën e plotësimit të kuadratit përkatës në kartelë kur silanimi bëhet nga mjeku stomatolog i shkollës.

Emërtimi dhe lloji i silantit kanë rëndësi të dihen për dy arsye:

- Në rast se silanti është material me çlirim fluori, efekti parandalues është i dyfishtë.

- Gjatë vlerësimit të cilësisë së silantit dhe kohëqëndrimit të tij në gojë është e nevojshme të individualizohen nxënësit/brezat e nxënësve të silanuar me një lloj silanti dhe ata të silanuar me një lloj tjetër.

Për qëllime studimore, mjeku stomatolog mund të shënojë vrojtimit përkatëse në kuadratet “Shënime” në faqen e fundit të kartelës.

Lloji i silantit të përdorur:	SILANIMET
Fissurit FX	16 Dt. xx / xx / 20xx 26 Dt. xx / xx / 20xx

Fig. 9. Plotësimi i kartelës kur mjeku stomatolog i shkollës silanon dhëmballët e para majtas e djathtas të nofullës së sipërme. Në kuadratin e majtë është shënuar emërtimi i njërit prej llojeve të silanteve të përdorura në SHSP – Tiranë.

2. Faqja e dytë

Në faqen e dytë të kartelës do të shënohen të dhënat e nxjerra nga depistimi i dhëmbëve. Kjo faqe është e njëjtë me faqen përkatëse të kartelës së vjetër, vetëm se janë zmadhuar hapësirat e plotësimit për të ndihmuar pasqyrimin më të qartë të informacionit.

Gjatë plotësimit të kësaj faqeje do të kihen parasysh disa momente kryesore:

1. Sipas udhëzimeve të OBSH-së, depistimi do të kryhet me sy të lirë, vetëm me ndihmën e një pasqyre dentare, në mjedise me ndriçim të plotë natyral.

2. Kartela mund të plotësohet paralelisht me depistimin ose të dhënat mund të hidhen në një fazë të dytë me qetësi në kabinetin dentar.

Faqja e dytë është e organizuar në këtë mënyrë (figura 10.1):

1. Numrat në të djathtë të faqes së dytë tregojnë klasën e fëmijës.
2. Hapësira e parashikuar për një depistim është e ndarë në katër kuadrate, një për çdo anë nofulle.
3. Dhëmbët e pranishëm në gojë do të plotësohen me shkrim dore, me numra romakë për dhëmbët e qumështit (nga V te V për çdo nofull) dhe me numra arabë për dhëmbët e përhershëm (nga 8 te 8).
4. Shenjat konvencionale që do të vihen mbi dhëmbë sipas rastit përkatës janë pasqyruar në faqen e katërt të kartelës, në zërin “Shenjat konvencionale të plotësimit të kartelës” (figura 13).
5. Shenjat konvencionale do të vendosen mbi numrin e dhëmbit përkatës për nofullën e sipërme dhe nën numrin e dhëmbit për nofullën e poshtme.

5. Mbi dhëmbët që gjykohen të paprekur nga kariesi nuk vendoset asnjë shënim.

6. Në rast se gjatë një depistimi vihet re mungesa e një dhëmbi në gojë dhe në kartelë nuk ka të dhëna të mëparshme për heqjen apo mosdaljen e tij, në kuadratin përkatës shënohet dhëmbi i qumështit dhe vendoset një x mbi të (në nofullën e sipërme) dhe nën të (në nofullën e poshtme).

7. Gjendja e gojës e vënë re gjatë depistimit në semestrin e parë do të shënohet në kolonën e parë dhe ajo e vënë re gjatë depistimit në semestrin e dytë do të shënohet në kolonën e dytë.

8. Përbri çdo depistimi do të shënohet emri i mjekut dhe data e depistimit. Duke qenë se pritet të ketë dallime të vogla ndërmjet mjekëve stomatologë gjatë depistimit me sy të lirë, emri i mjekut është veçanërisht i domosdoshëm të dihet kur ndërrohet mjeku i shkollës apo kur fëmija ndërrohet shkollë. Vlera e kësaj është studimore dhe merr rëndësi të veçantë gjatë përcaktimit të indekseve të sëmundjes karioze.

Në figurën 10.2 dhe 10.3 janë dhënë respektivisht shembujt e plotësimit të kartelës për klasat e para të shkollës fillore dhe klasat e dhjeta të shkollës së mesme.

DEPISTIMI								
Nr.	Data	Mjeku	Semestri I		Semestri II		Mjeku	Data
1								
2								
3								
4								

Fig. 10. 1. Pjesë nga faqja e dytë e kartelës së re stomatologjike

Në anën e majtë është vendosur skema e dhëmbëve të përhershëm, të cilët janë shënuar me numra arabë nga 18 te 48 (shifra e parë tregon kuadratin dhe shifra e dytë dhëmbin). Në anën e djathtë është paraqitur skema e dhëmbëve të qumështit, me shifra arabe nga 55 te 85.

Shënimet do të bëhen në tabelë.

Në kolonën *“Dhëmbi”* do të shënohet numri i dhëmbit që është trajtuar.

Në kolonën *“Data”* do të shënohet data në të cilën përfundon trajtimi i dhëmbit. Në disa raste, veçanërisht në ato të periodontiteve akute, mjekët mund të shënojnë datën e fillimit e të përfundimit të trajtimit (P. sh. x1 - x2 /xx/ 20xx).

Në kolonën *“Diagnoza”* do të shënohet patologjia e dhëmbit:

Karies sipërfaqësor

Karies i mesëm

Karies i thellë

Karies i thellë me zbulim të dhomës pulpare gjatë trajtimit

Pulpit akut

Pulpit kronik

Gangrenë e pulpës

Periodontit akut

Ndërrim dhëmbësh

Rrënjë e mbetur në gojë

Diagnoza mund të plotësohet edhe me disa nga të dhënat e marra gjatë anamnezës së pacientit, kryesisht në lidhje me dhimbjen: dhimbje nga të ëmblat, dhimbje në kafshim, dhimbje natën pa shkak. Në rastet kur vendi nuk e lejon, mund të kalohet në rreshtin më poshtë. Ndërsa për format kur mjeku dëshiron të mbajë shënime të hollësishme, mund të kalohet në faqen e katërt, në rubrikën *“Shënimet”*.

Në kolonën *“Mjekimi”* do të përshkruhet trajtimi përkatës:

Trepanim

Mbushje

Heqje

Mjekim biologjik

Ekstirpim

Amputim

Metodë e kombinuar

Kuadrati do të plotësohet edhe me të dhënat për faqet e mbushura, llojin e materialit të mbushjes (amalgam apo kompozit), materialet izoluese të përdorura

(Ca (OH)₂, cement), materialet e përdorura për mbushjen e kanaleve të rrënjës (Ca (OH)₂, endometazon + kongutaperka). Gjatë plotësimit mund të përdoren shkurtime. Në rast se hapësira nuk e lejon, mund të kalohet në rreshtin më poshtë. Në rast se mjeku ka nevojë të bëjë një përshkrim më të detajuar të trajtimit, mund të kalojë në rubrikën "Shënime".

Figura 11 pasqyron rastin e një fëmije të cilit i është hequr dhëmbi 81 në periudhën e ndërrimit të dhëmbëve dhe më pas i janë mjekuar 16 dhe 26 respektivisht për shkak të një kariesi të mesëm dhe një pulpiti akut.

DIAGNOSTIKIMI DHE MJEKIMI																									
Dhëmbët e përhershëm								Dhëmbët e qumështit																	
18	17	16	15	14	13	12	11	21	22	23	24	25	26	27	28	55	54	53	52	51	61	62	63	64	65
48	47	46	45	44	43	42	41	31	32	33	34	35	36	37	38	85	84	83	82	81	71	72	73	74	75

Dhëmbi	Data	Diagnoza	Mjekimi	Dhëmbi	Data	Diagnoza	Mjekimi
16	xx/xx/xx	Karies media mesial	cement, amalgam OM	81	x ₃ /x ₃ /x ₃	ndërrim dhembesh	ekstraksion
26	xy/xy/xy	Pulpit akut, dhëmbjenatën, për shkak	S1: arsenik S2: pastrim kanalesh, endomet, gut, cement, komp.				

Fig. 11.

4. Faqja e katërt

Kjo faqe përmban

- hapësirën e parashikuar për shënime të ndryshme, të cilat nuk mund të bëhen në faqet përkatëse dhe

- shenjat konvencionale me të cilat do të plotësohet kartela.

Disa shembuj të plotësimit të hapësirave për shënimet janë dhënë në figurat 12. 1, 12.2 dhe 12. 3.

SHËNIME

*Frakturë e 11 si pasojë e rrezimit në oborrin e shkolles
Frakturë e kurores deri në 1/2, me hapje të dhomes pulpare
E pa trajtuar.
Fëmija ka qene 10 vjec*

Fig. 12.1 Rasti i plotësimit të të dhënave për një frakturë të 11.

SHËNIME

*Dhemb porcelani të 11.
Shkak: fraktura e dhembit me hapje të dhomes pulpare
Vendosur përpara tre muajsh nga një mjek stomatolog privat.*

Fig. 12. 2. Rasti i plotësimit të të dhënave për një punim protetik të vënë re në gojën e nxënësit.

SHËNIME

*Dt. xx/ xx/ 20xx Pacienti paraqitet me periodontit akut të 11.
Pastrohet masa karioze, pastrohen kanalet e rrenjes dhe
dhembli lihet i hapur që të drenofejë pusi.
Dt. xy/ xy / 20xy U bë mbushja e kaneleve dhe e kurores së*

Fig. 12.3. Një shembull i shënimeve që mund të mbahen gjatë mjekimit të një periodontiti akut. Të vihet re se mjeku mund të shkruajë këtu gjithçka të nevojshme të vënë re gjatë trajtimit.

Shenjat konvencionale të pasqyruara në këtë pjesë të kartelës (fig13.)do të përdoren gjatë plotësimit të faqes së dytë e të tretë të saj.

Në hapësirën e parashikuar për grafitë, zarfi i tyre do të fiksohet me kapëse metalike.

SHENJAT KONVENCIONALE TË PLOTËSIMIT TË KARTELËS DENTARE: O – mbushje S – silant F – Frakturë E – Ektopik – - kurorë artificiale	Grada e prishjes 2 3 4 X – mungesë √ – RRËNJË	Sipërfaqja e prekur M – meziale D – distale O – okluzale P – palatine L – Linguale V – vestibulare B - bucale	GRAFITË
--	---	--	---------

Punuan: Oriana Tamburi, Marvin Mersini, Elvis Xhaja, Zhelmira Thomaj

Fig. 13.

PËRFUNDIME

Kartela e re stomatologjike është praktike në përdorim dhe mund të plotësohet me lehtësi për çdo nxënës duke ndjekur udhëzimet përkatëse.

Në krahasim me kartelat e mëparshme të Shërbimit Stomatologjik Publik, ajo përmban disa koncepte të reja, si: të dhënat e përgjithshme më të detajuara, hapësirën për marrjen e miratimit të prindit për trajtimin e fëmijës, hapësirën për përshkrimin e silanimeve, hapësira për shënime të ndryshme e të nevojshme gjatë punës me nxënësit etj. Ndërsa faqja për depistimin e dhëmbëve ka mbetur e pandryshuar, faqja për mjekimin është konceptuar ndryshe, duke u lënë mundësi mjekëve stomatologë që të përshkruajnë në një mënyrë më të detajuar patologjinë e dhëmbëve dhe mënyrën e mjekimit.